

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI
PROGRAMI: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema me titull:

**Ndikimi i pagesave direkte në rritjen dhe zhvillimin e tregtimit të produkteve
agro-ushqimore në komunën e Vushtrrisë**

Udhëheqësi shkencor:

Prof. Ass. Dr. Njazi Bytyqi

Kandidatja:

Bsc. Lorik Veseli

Prishtinë, Janar, 2022

Abstrakti

Pagesat direkte janë pika kyçe e politikave të përbashkëta bujqësore të Bashkimit Evropian, dhe si të tilla gjejnë zbatim edhe në vendin tonë si përkrahje financiare për fermerin vendor. Marrë parasysh se pagesat direkte jepen si mbështetje financiare për fermerin vendor, edhe objektivi i këtij studimi është të studiohet efekti i tyre në rajon të caktuar e në këtë rast në komunën e Vushtrrisë.

Hulumtimi është zhvilluar në komunën e Vushtrrisë, me fermerë përfitues të pagesave direkte. Intervistimi i fermerëve është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të pyetësorit, ku madhësia e mostrës përbehet prej 100 intervista me përfitues të pagesave direkte. Të dhënat janë marrë dhe përpunuar me programet softuerike Excel dhe SPSS.

Rezultatet e studimit tregojnë se pagesat direkte kanë pasur ndikim pozitiv në rritjen e prodhimit dhe tregtimit të produkteve agro-ushqimore në Komunën e Vushtrrisë dhe ekskluzivisht pagesat direkte në shumicën e rasteve dërmuese fermerët i kanë shfrytëzuar pagesat direkte për mbulimin e kostove operacionale të tyre.

Ndërsa në mënyrën se si jepen pagesat direkte në vendin tonë 98% mendojnë se duhet të vazhdohet me mënyrën e pagesave direkte për sipërfaqe të tokës së kultivuar dhe pjesa tjetër prej 2% mendojnë se duhet të ndërrohet mënyra e shpërndarjes të pagesave direkte, pra nga sipërfaqja e kultivuar nga sasia e prodhuar ose të ndryshohet kategorizimi i dhënies së pagesave direkte.

Fjalët kyçe: Pagesa direkte, fermeri vendor, përfitues të pagesave direkte